

Mbrojtja e të dhënave: Në përputhje me GDPR-në.

Siç mund të jeni në dijeni, Bashkimi Evropian ka miratuar Rregulloren e përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave (GDPR), e cila ka hyrë në fuqi më 25 maj 2018.

Ndonëse “Nënat në lutje” është e vendosur në Zvicër, ne shërbejme me shumë gra në BE dhe jemi përkushtuar të jemi në përputhje me GDPR-në.

Politikat e privatësisë / Të drejtat e përdorimit

“Nënat në lutje” zotohet se asnjëherë nuk do të shesë apo japë në përdorim të dhënat tuaja personale konfidenciale. Ne do të ndërmarrim çdo hap të nevojshëm për t’ju siguruar se informacioni juaj financiar dhe personal do të qëndrojë i sigurt. Ne duam që ju të jeni të sigurt gjatë vizitës në faqen tonë të internetit. Për këtë arsye, ju kërkjme të merrni pak kohë për të lexuar informacionin e mëposhtëm.

Mbledhja e informacionit

“Nënat në lutje” NUK mbledh të dhënat tuaja personale pa dijeninë tuaj, gjatë vizitës suaj në faqen tonë. Megjithatë, “Nënat në lutje” ju lejon juve të ofroni informacionin tuaj personal në faqen tonë. Lloji i informacionit që ne mbledhim është në përputhje me shërbimin që ju kërkoni. Për shembull, ju mund të bëni donacione, mund të regjistroni grupin tuaj, mund të regjistroheni për të marrë postën tonë elektronike (e-mail). Lloji i informacionit që ne mbledhim është vetëm informacioni i nevojshëm për të mundësuar përgjigjen tonë ndaj kërkesës suaj specifike, si p.sh. emri dhe informacioni për kontaktim.

Nëse po regjistroheni si drejtuese grupi, “Nënat në lutje” do të duhet të mbledhë të dhënat tuaja të nevojshme për të kryer këtë transaksion, i cili përfshin informacionin tuaj të kontaktit që do të ruhet në një bazë të sigurt të dhënash. Ky informacion do të përdoret për të lidhur nënat e tjera me ju dhe grupin tuaj. Gjithashtu, informacioni përdoret për t’ju dërguar lajme dhe inkurajime nga shërbesa jonë. Për ata që japin financiarisht për shërbesën tonë, informacioni juaj përdoret për të regjistruar dhuratat tuaja, që të mund t’ju falënderojmë, ose për t’ju dërguar faturat për arsye taksash.

Nëse ju ndani ide, komente, mendime, dëshmi personale, kërkesa lutjeje, bëni pyetje etj., “Nënat në lutje”, me lejen tuaj, e mbledh këtë informacion dhe mund ta përdorë në një nga mënyrat që shpjegohet në seksionin e mëposhtëm, të titulluar “Përdorimi i informacionit”.

Përdorimi i informacionit

“Nënat në lutje” e përdor informacionin e siguruar prej jush në këto mënyra:

- ♥ Për t’ju përgjigjur korrespondencës suaj, pyetjeve, komenteve, sugjerimeve, ideve, mendimeve, lutjeve, shqetësimeve për të përmbushur një kërkesë.
- ♥ Nëse jeni drejtuese e një grupi “Nënat në lutje” do ta përdorë informacionin tuaj për të lidhur një nënë që dëshiron të bashkohet me një grup lutjeje për shkollën e fëmijëve të saj.
- ♥ Vazhdimisht përditëson, zhvillon, bën plan dhe përshtat përmbajtjen e faqes sonë me nevojat dhe interesat e audiencës sonë.
- ♥ Si një drejtuese e regjistruar, anëtare ose e interesuar për shërbesën “Nënat në lutje”, ju do të merrni postë elektronike dhe postë të thjeshtë.
- ♥ Mund të kontaktoheni për të konfirmuar kërkesa ose informacione specifike, të konfirmoni informacione për abonim, të informoheni për oferta të veçanta dhe materiale të reja, ose për t’ju ofruar informacione që ne mendojme se do t’ju interesojnë.

Transparenca / Ndarja e informacionit

Siç e thamë edhe më sipër, “Nënata në lutje” nuk shet apo jep hua informacionin tuaj te të tjerët. Në disa raste, “Nënata në lutje” bashkëpunon me shërbesa të ngjashme. Në këto raste, “Nënata në lutje” mund të vërë në dijeni partnerët tanë për këto bashkëpunime. Megjithatë, ne nuk do t’ia japim informacionin tuaj personal asnjë shërbese tjetër.

Politika e Privatësisë së Dhuruesve

Moms in Prayer International nuk do të reklamojë, nuk do të marrë ose japë të tjerëve informacionin e dhuruesve, as nuk do të dërgojë postë elektronike tek dhuruesit tanë në emër të organizatave të tjera.

Kjo politikë zbatohet për të gjitha informacionet e marra nga Nënata në Lutje, si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu dhe në internet, si dhe çdo komunikim elektronik, me shkrim ose me gojë. Meqenëse çdo dhurim përpunohet nëpërmjet vlerësuesit të shërbimit të palës së tretë, informacioni i dhuruesve tanë do të përdoret vetëm për qëllimet e nevojshme për të përpunuar dhurimin.

Përsa u përket drejtimeve në faqet e treta të internetit.

“Deklarata e privatësisë” së “Nënave nëlutje” nuk ka fuqi mbi shkëmbimin e informacionit tuaj në faqe të palëve të treta. Ne ju rekomandojmë që të lexoni politikat e tyre për përdorimin e informacionit, para se të lundroni në faqen e tyre, dhe sidomos para se të ndani informacionin tuaj personal. Në të njëjtën mënyrë, kjo “Deklaratë privatësie”, nuk ka fuqi mbi praktikatat e palëve të treta, për të cilat faqja jonë mund të ketë linqe.

Redaktimi dhe fshirja e informacionit

Nëse doni të korrigjoni, të përditësoni, të shtoni apo të fshini informacionin, na njoftoni duke na shkruar në këtë adresë: Moms in Prayer in Europe, Bordeaux-Str.5, Ch-053 Basel, Switzerland, ose email: roster@momsinprayer.eu

Ndryshimet

“Nënata në lutje” ka të drejtë të ndryshojë këtë “Deklaratë privatësie” pa kufizim, dhe iu kërkon që t’u kushtoni vëmendje përditësimeve.

Pyetje ose sugjerime

Ju lutem, na shkruani me pyetje ose komente që kanë të bëjnë me këto politika privatësie në: Moms in Prayer in Europe, Bordeaux Str.5, Ch-4053 Basel, Switzerland, ose me email: mip.europe@momsinprayer.eu

Kjo faqe interneti mund të ketë linqe të faqeve të tjera që administrohen nga individë apo organizata jashtë faqes sonë “Nënata në lutje”. Në momentin që ju drejtoheni te një faqe tjetër dhe keni të drejtë për të hyrë tek informacioni i tyre, i nënshtroheni rregullores së tyre të privatësisë.

Deklarata e përdorimit

E gjithë përmbajtja, imazhet, logot dhe fototgrafitë që shfaqen në këtë faqe interneti, i nënshtrohen ligjit për të drejtat e autorit dhe janë pronësi e faqes/grupit “Nënata në lutje”. Imazhe të tjera, marka apo logo, janë pronësi e pronarëve përkatës. Informacioni dhe imazhet që gjenden në këtë faqe nuk mund të riprodhohen në asnjë formë elektronike apo formë tjetër, pa lejen me shkrim të faqes/grupit “Nënata në lutje”. Nga faqja jonë e internetit mund të drejtoheni në faqe të tjera të treta. Këto faqe janë që ju t’i përdorni sipas nevojës. “Nënata në lutje” nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e këtyre faqeve të treta dhe, nëse nuk thuhet shprehimisht, nuk mbështet këto faqe dhe përmbajtjen, produktet dhe shërbimet e tyre. “Nënata në lutje” nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e faqeve të internetit të sponsorve nga ku mund të jeni drejtuar nga faqja jonë. Mendimet dhe idetë e shprehura në faqet e internetit të sponsorve nuk reflektojnë patjetër ato të faqes/grupit “Nënata në lutje”.